



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 683
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Petrovë

E premte, më 13 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 17:45 – 19:25

Vendi i takimit: SHF "Bajram Curri"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emini, Drejtori i drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Asambleistët – Besnik Seferi dhe Asllan Beqaj.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Faleminderit që ju keni përgjigjur ftesës që sot të jeni të pranishëm në këtë takim, të cilët jemi duke i mbajtur në të gjitha fshatrat, sot pra i ka ardhur rradha që ta mbajmë në Petrovë . Ju e dini që çdo vit korniza afat mesme buxhetore ka kaluar në dëgjim publik, unë sot këtu jamë bashkë me Drejtorin e Urbanizmit, Grejtalb Emini, Drejtorin e Shërbimit publik, Bardhyl Rushiti, asambleistët: Besnik Seferi, Asllan Beqaj, Muhamet Ademaj si dhe me Gentiana Mehmetin pjesë e kabinetit tonë.

Sot ne kemi ardhur këtu që ta prezantojmë buxhetin për vitin 2026 dhe njëkohësisht t'i marrim kërkesat nga banorët se çfarë ka nevojë të investohet në fshatin Petrovë.

Ju e dini edhe nga dëgjimet buxhetore të mëhershme që ne i marrim kërkesat të cilat janë më prioritare dhe i vendosim në buxhet.

Realisht buxheti nuk dallon edhe shumë për sa i përket investimeve kapitale nga viti i kaluar, do të thotë është 2.5 milion euro për të gjitha fshatrat dhe për pjesën e qytetit. Gjithësej ne i kemi 22 vendbanime dhe ndarje e buxhetit si qeverisje e kemi bërë në mënyrë propocionale dhe të barabart për çdo fshat.

Buxheti këtë vit është afërsisht 11.5 milion euro, por ju duhet të keni parasysh që 50% e këtij buxheti shkon në paga dhe mëditje, ndërsa pjesa tjetër ndahet në mallra dhe shërbime, subvencione si dhe investime kapitale.

Ne sot jemi këtu që t'i marrim kërkesat e banorëve në mënyrë që t'i involvojmë në buxhetin e vitit 2026, prandaj fjala tani është për ju.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Petrit Rexhaj:** Procka tek lagjia Rexhaj e Beqaj, duhet të rregullohet pasi që është mjaft e rëndësishme për ni si lagje, kemi probleme pasi që uji po hyn në oborre të shtëpive. A mund të dijm se cfarë ka ndodhur me këtë projekt?
Po ashtu një pjesë për ecje është e nevojshme të bëhet nga ura deri te fusha e sportit, pasi që ajo pjesë nuk po është e frekuentueshme shkaku që nuk ka hapsirë për ecje.
Ndriçim publik rruga kryesore “Haqif Hysenaj” 200 m
Po ashtu çështja e lumit dhe kanalizimit është jetike për fshatin nëse ka mundësi të dim më shumë sa i përketë kësaj.
- **Ilir Tërshani:** A është ne projekt rregullimi i lumit?
Trotuari duhet të rregullohet nga shkolla deri tek lagjia “Kadri Ademaj” e cila lidhet me rrugën Tërshani.
- **Jajush Ademaj:** Kanalizimi duhet të rregullohet në rrugën “Xhemshir Xhemshiri”, si dhe rregullimi i prockës.
- **Alban Rashiti:** Ne rrugën “Mehdi Korani”, të vendoset një tabelë për mos të hyjn peshat e rënda, po ashtu nëse ka mundësi të bëhet edhe ndriçimi si dhe nëse ka mundësi trotuari. Duhet të rregullohet uji i pijes për fshatin Petrovë sidomos te shkolla.
- **Armend Rashtiti:** Të vazhdojë trotuari deri tek ura.
- **Baki Rashiti:** Kemi probleme të madh me mbeturinat, a është në plan që të hiqen?
Në rrugicë në “Nazim Bakiu”, të vendosen tabelat.
Te rruga kryesore, kur do të rregullohet dhe kur do të hiqen pengesat të cilat janë vendosur?
- **Sevdali Hiseni:** Rruga “Mehdi Korani”, dhe “Haxhi Zeka”, të bëhet një rreth.
- **Albert Hiseni:** Pse është ndalur trotuari dhe a do të ketë ndonjë plan për rivitalizimin e kanalizimit në rrugën “Haxhi Zeka” ?
- **Veli Ademaj:** Në lagjen Ademaj, kanalizimi i cili është rregulluar, kanë mbetur disa shakta, kur do të rregullohen ?
- **Bafti Hysenaj:** A ka ndonjë afat se kur do të hiqen kamionët dhe çështja e varrezave a do të mirëmbahen nga komuna apo duhet në mënyrë private?

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Petrovë

Date: 13.06.2025

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Alban Rashiti	
2	Muhamet Ademaj	
3	MARJUSHPIDEMAJ	
4	Bufti Hysemaj	
5	Kabri Rosliti	
6	ARMEND RASHITI	
7	HIDAJET BEGAJ	
8	Xhema Trohani	
9	VEH° ALI° ALI°	
10	BOKI ROSHITI	
11	Albert Hiseni	
12	PETRI RASHAN	
13	Shir Terhami	
14	ARMEND RASHITI	
15	Sevdolp Hiseni	
16		
17		

18		
19		
20		
21		
22		
23		
24		
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		
38		
39		
40		
41		